

**Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren**

**RAPORTI PËRMBLEDHËS  
I REZULTATEVE TË VLERËSIMIT  
2021**



UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN  
UNIVERSITY “UKSHIN HOTI” PRIZREN

## Përmbajtja

1. Hyrja .....	3
2. Vlerësimi i mësimdhënësit/asistentit nga studentët (shtojca A.1.) .....	4
3. Vlerësimet ndërkolegial (shtojca A.2.) .....	17
4. Raport i vlerësimit nga dekani (shtojca A.3.) .....	19
5. Vlerësimi për publikimet shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca (shtojca A.4.) .....	22
6. Raport i vlerësimit për kontributin në universitet dhe shoqëri (shtojca A.5.) .....	24
7. Vlerësimi gjithëpërfshirës (shtojca A.6.) .....	26
8. Vlerësimi i performancës së dekanit (shtojca A.7.) .....	38
9. Vlerësimi nga studentët e diplomuar (shtojca A.8.) .....	45
10. Vlerësimi nga stafi akademik .....	45
10.1. Vlerësimet nga stafi akademik (shtojca A.9.) .....	45
11. Vlerësimi nga stafi i administratës .....	67
11.1. Vlerësimet nga stafi i administratës (shtojca A.10.) .....	67
12. Vlerësimi nga Bordi Këshilldhënës Industrial (BKI) .....	84
12.1. Vlerësimi nga BKI (shtojca A.11.) .....	84
13. Monitorimi i braktisjes së studentëve .....	91
13.1. Rezultatet e monitorimit të braktisjes së studentëve (shtojca A.12.) .....	91
14. Vëzhgimi ndërkolegial i orës mësimore .....	92
14.1. Rezultatet e vëzhgimit ndërkolegial të orës mësimore (shtojca A.13.) .....	92
15. Vetëvlerësimi i mësimdhënësve .....	93
15.1. Rezultatet e vetëvlerësimit të mësimdhënësve (shtojca A.14.) .....	93
16. Plani i zhvillimit profesional të mësimdhënësit/asistentit .....	103
16.1. Plani i zhvillimit profesional të mësimdhënësit/asistentit (shtojca A.15.) .....	103
17. Gjurmimi i studentëve (ALUMNI) .....	106
17.1. Gjurmimi i studentëve (shtojca A.16.) .....	106

## 1. Hyrja

### **Zyra për Sigurim të Cilësisë**

Zyra për Sigurim të Cilësisë vepron në kuadër të Administratës Qëndrore të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren. Krijimi dhe avancimi i vazhdueshëm i politikave dhe praktikave të universitetit në funksion të ngritjes së cilësisë, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Arsim të Lartë, Standardet e Sigurimit të Cilësisë në Zonën Evropiane, Standardet e Akreditimit/Agjencioni i Akreditimit të Kosovës dhe Rregulloren për Sigurim të Cilësisë. Zyra për Sigurimin e Cilësisë si epror operativ është Prorektori për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Ngritje të Cilësisë, ndërsa epror administrativ është Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit. Matja e cilësisë bëhet me instrumentet e përfshira në Rregullore për Sigurimin e Cilësisë të draftuara nga Komisioni Qendror i Sigurimit të Cilësisë, të miratuara në Senat.

Raportet e hartuara nga Komisionet e Sigurimit të Cilësisë në nivel të njësive akademike, duke përfshirë rekomandimet të cilat dalin nga rezultatet e vlerësimit u dërgohen menaxhmentit, së bashku me hartimin e raportit përmbledhës. Me këtë rast njoftohen edhe dekanët dhe udhëheqësit administrativ (palët e interesit) me qëllim të planifikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Po ashtu, njoftohen edhe palët e tjera të interesit. Raporti përmbledhës është publik në web faqen e universitetit.

Pyetësorët A1, A2, A3, A4, A5, A6 dhe A13 lansohen dy here në vit, përderisa pyetësorët tjerë lansohen në fund të vitit. Pyetësori A8 dhe A12 janë vazhdimisht në process gjatë çregjistrimit dhe diplomimit të studentëve. Pyetësorët janë anonim dhe sigurojnë konfidencialitet të plotë. Performanca e stafit akademik përmban pesë shtylla të vlerësimit nga pyetësorët A1, A2, A3, A4 dhe A5, rezultatet e të cilave pasqyrojnë performancën e stafit për semestër dhe vit. Stafi akademik njoftohet për performancë e realizuar në mënyrë të vazhdueshme (çdo semestër).


## 2. Vlerësimi i mësimdhënësit/asistentit nga studentët (shtojca A.1.)

Pyetësi është i destinuar për studentët e nivelit baçelor dhe master. Pyetësi përfshin 17 pyetje për mësimdhënësit dhe 16 pyetje për asistentët dhe një pyetje të hapur. Vlerësimi bëhet nga 1-5. Pyetësi përfshin pyetjet lidhur me:


- mësimdhënien,
- raportin me studentët, kodin etik.

Pyetësi është hartuar në mënyrë që të siguroj informacione rreth zbatimit të plotë të syllabusit, zhvillimin profesional, metodat e mësimdhënies, menaxhimin e kohës, kënaqshmërinë në vlerësim, gadishmërinë për ofrimin e konsultimeve dhe sjelljen e mësimdhënësve/asistentëve. Pyetësi realizohet dy herë në vit në fund të semestrit dhe është një ndër shtyllat e treguesit të performancës së stafit akademik.


Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit. Mësimdhënësit dhe asistentët njoftohen për performancën e tyre si dhe mund t'i shohin rezultatet e pyetësoreve në kohë reale në sistemin elektronik në profilin e tyre. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Pyetësit iu janë përgjigjur 12,868 herë studentët në semestrin veror dhe 13,630 herë janë në semestrin dimror. Pra, pyetësit A1 iu janë përgjigjur rreth 6,020 studentë. Rezultatet e pyetësit janë të kënaqshme me vlerësim 4,38 në nivel universiteti, nga vlerësimi i plotë 5.




Në fillim të semestrit, mësime/ndërrësit/ja ka prezantuar syllabusin/përmbajtjen e lëndës dhe metodat e vlerësimit.




Mësime/ndërrësit/ja ka qenë i rregullt në ligjerata.




Mësime/ndërrësit/ja ka shoqëruar ligjëratat me shembuj dhe ilustrime të cilat ndihmojnë në kuptimin e përmbajtjes së ligjëratës.




Mësimdhënësi/ja ka përdorur teknologjinë bashkëkohore të mësimdhënies (p.sh. projektorët, internetin, simulatorët).




Mësimdhënësi/ja ka treguar gatishmëri për t'iu përgjigjur pyetjeve të studentëve dhe ka treguar kompetencë për lëndën.




Mësimdhënësi/ja gjatë ligjeratave ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë.




### Mësimdhënësi/ja i jep rëndësi pjesëmarrjes së studentëve në ligjerata.






### Mësimdhënësi/ja ka përdorur burime/literaturë bazike dhe burime shtesë në mësimdhënie.




### Mësimdhënësi/ja ka integruar konceptet teorike dhe praktike për lëndën (nëse aplikohen ushtrimet).









Sa ka shprehur gadishmëri mësimdhënësi/ja në ofrimin e konsultimeve jashtë orarit të ligjeratave?






Mësimdhënësi/ja është sjellur në përputhje me kodin etik.




Sa ju ka ofruar mësimdhënësi informacione për trendet aktuale që lidhen me lëndën?







### Asistenti/ja ka qenë i përgatitur dhe ka treguar kompetencë për lëndën.




### Sa i është përmbajtur asistenti/ja syllabusit/përmbajtjes së lëndës?




### Asistenti/ja gjatë ushtrimeve ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë.




### Asistenti/ja i jep rëndësi pjesëmarrjes së studentëve në ushtrime.






### Asistenti/ja ka përdorur burime të mjaftueshme në ushtrime.




### Asistenti/ja ka kontribuar në integrimin e koncepteve teorike dhe praktike për lëndën. (nëse aplikohen ushtrimet)







Sa ka shprehur gadishmëri asistenti/ja në ofrimin e konsultimeve jashtë orarit të ushtrimeve?






Asistenti/ja është sjellur në përputhje me kodin etik.



Sa ka përdorur prezantime (me slajde) në kushtet e ligjërimit online?





### **Rekomandimet e KSC-së në nivel të njësive akademike:**

- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
  
- Fakulteti Ekonomik:
  1. Të bëhet ndarja e lëndëve sipas semestrave, të mos përfshihen lëndët e semestrit dimëror në semestrin veror.
  2. Gjatë vlerësimit të studentëve mundësisht të bëhet ndarja e pyetësorëve me pyetjet e dedikuara për profesorë, të jenë të ndarë, jo në një pyetësor, të vlerësohet profesori dhe asistenti.
  3. Të vendoset emri i asistentëve për lëndët në të cilat u bëhet vlerësimi, e jo në sistem të figuron emri i profesorëve të lëndëve.
  
- Fakulteti i Filologjisë: Nuk ka!
  
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: Nuk ka!
  
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
  
- Fakulteti Juridik:
  1. të saktësohet numri i studentëve që duhet të bëjnë vlerësimin; të përshkruhen rezultatet veç e veç për secilën pyetje.




### 3. Vlerësimi ndërkolegial (shtojca A.2.)




Pyetësi është i destinuar për stafin akademik. Vlerësimi ndërkolegial realizohet dy herë në vit dhe është një ndër shtyllat e treguesit të performancës së stafit akademik. Pyetësi është lansuar për të gjitha njësitet akademike. Pyetësi është i ndarë në 4 nivele të cilat vlerësohen nga 1-5.

- Bashkëpunimi kolegial
- Komunikimi kolegial,
- Marrëdhëniet ndërpersonale,
- Sjellja etike kolegiale.

Pyetësi ka për qëllim identifikimin e përparësive dhe nevojave për përmirësim në marrëdhëniet ndërkolegiale. Mësimdhënësit njoftohen për performancën e tyre çdo semestër përfshirë edhe vlerësimin ndërkolegial. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Pyetësit i janë përgjigjur 115 respondentë, si në vijim: 19 respondentë nga Fakulteti i Edukimit me notën 4,8, 18 respondentë nga Fakulteti Ekonomik me notën 3,8, 13 respondentë nga Fakulteti i Filologjisë me notën 4, 10 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit me notën 4,5, 43 respondentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me notën 4,6 dhe 13 respondentë nga Fakulteti Juridik me notën 4,3. Vlerësimi ndërkolegial në nivel universiteti është 4,3. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit.





### **Rekomandimet e KSC-së në nivel të njësive akademike:**




- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
  
- Fakulteti Ekonomik:
  1. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit dhe komunikimit, si dhe të marrëdhënieve ndërpersonale dhe sjelljeve etike në mes të stafit akademik.
  2. Të bëhet vlerësimi profesional për kolegët e jo të shkohet me tendencë.
  
- Fakulteti i Filologjisë:
  1. Personeli akademik këshillohet që të përmirësojë bashkëpunimin kolegjial, komunikimin kolegjial, marrëdhëniet ndërpersonale dhe sjelljen etike kolegjiale.
  
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: Nuk ka!
  
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
  
- Fakulteti Juridik: Nuk ka!


### **4. Raport i vlerësimit nga dekani (shtojca A.3.)**

Pyetësi është i destinuar për dekanët për vlerësimin e stafit akademik të njësive akademike dhe realizohet dy herë brenda vitit dhe është një ndër shtyllat që përcaktojnë performancën e stafit akademik. Pyetësi është ndarë në 4 shtylla/kategori për vlerësim, si dhe një pyetje të hapur me ç'rast vlerësohet:

- vijueshmëria e rregullt (10%),
- mbajtja e rregullt e provimeve dhe konsultimeve (5%),
- sjellja etike me studentë dhe kolegë (5%).

Qëllimi i pyetësit është vlerësimi nga udhëheqësi i njësisë akademike me qëllim të sigurimit të informacioneve për përmirësim. Mësimdhënësit në kohë reale njoftohen për vlerësimin e tyre nga dekani në sistemin elektronik/profilin e tyre. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësi.







### **Rekomandimet e KSC në nivel të njësive akademike:**


- Fakulteti i Edukimit:
  1. Mësimdhënësit, të cilëve u mungojnë punimet shkencore dhe pjesëmarrjet në konferenca, rekomandojmë që të angazhohen për të bërë hulumtime, kërkime shkencore dhe të marrin pjesë në konferenca.
- Fakulteti Ekonomik:
  1. Vlerësimi për prof. Shukri Maxhunin bëhet në FSHJM, pasi që ka vendim si i rregullt në atë fakultet.
  2. Marrëdhëniet personale-individuale të mos reflektojnë në vlerësimin e stafit.
- Fakulteti i Filologjisë:
  1. Në semestrin dimëror nuk është bërë vlerësimi nga ana e dekanit.
  2. Për asistentin Liridon Buqaj nuk ka një formular të veçantë të vlerësimit. Vlerësimi i tij është përmendur në komentin e Prof.Asoc.Dr. Albana Milaimi.
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
- Fakulteti Juridik:
  1. Të kalkulohet përqindja e dekanit të njësisë akademike.
  2. Mbajtja e rregullt e provimeve dhe konsultimeve të saktësohet për profesor dhe asistent.

## 5. Vlerësimi për publikimet shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca (shtojca A.4.)

Pyetësi është i destinuar për stafin e rregullt akademik me qëllim të evidentimit të arritshmërisë së stafit në publikimin e punimeve shkencore (1 punim shkencor në platformat sipas UA MASHT) dhe vlerësohet me 0% ose 15%, dhe pjesëmarrjen në konferenca, kongrese dhe punëtori që vlerësohet me 0% ose 5%. Vlerësimi bazohet në prova faktike. Pyetësi realizohet dy herë në vit dhe është një nga shtyllat që përcaktojnë performancën e stafit akademik. Universiteti synon që rezultatet të jenë të matshme me qëllim të sigurimit të cilësisë në universitet.

Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Në plotësimin e pyetësit janë përgjigjur 83 respondentë. 19 respondentë janë nga Fakulteti i Edukimit, 18 respondentë nga Fakulteti Ekonomik, 13 respondentë nga Fakulteti i Filologjisë, 10 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, 10 respondentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe 13 respondentë nga Fakulteti Juridik. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësi.





### **Rekomandimet e KSC në nivel të njësive akademike:**


- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
- Fakulteti Ekonomik:
  1. Kërkohet që stafi akademik të angazhohet për pjesëmarrje në konferenca, kongrese dhe punëtori.
- Fakulteti i Filologjisë:
  1. Personeli akademik këshillohet të botojë publikime shkencore, pjesëmarrje në konferenca dhe kontribut për universitetin dhe për shoqërinë.
  2. Disa mësimdhënës nuk i kanë ofruar të dhënat e tyre.
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: Nuk ka!
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
- Fakulteti Juridik:
  1. Një pjesë të stafit i janë llogaritur pjesa e hulumtimit në mungesë të formularit (në formularin tjetër i gjeni me fusnota).

## 6. Raport i vlerësimit për kontributin në universitet dhe shoqëri (shtojca A.5.)



Pyetësi është i destinuar për stafin e rregullt akademik me qëllim të nxitjes së stafit në pjesëmarrje në komisione, grupe punuese, grupe të ekspertëve të universitetit si dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet e komunitetit (punë vullnetare, punëtori, ekspertiza etj.). Kontributi aktiv në komisione, grupe punuese, grupe të ekspertëve të universitetit vlerësohet 0% ose 10%, si dhe pjesëmarrja aktive në aktivitetet e komunitetit (punë vullnetare, punëtori, ekspertiza etj.) vlerësohet me 0% ose 10%.

Pyetësi realizohet dy herë në vit për stafin e rregullt akademik dhe është një ndër shtyllat që përcaktojnë performancën e stafit akademik. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Universiteti synon që rezultatet të jenë të matshme me qëllim të sigurimit të cilësisë në universitet.

Në plotësimin e pyetësit janë përgjigjur 83 respondentë. 19 respondentë janë nga Fakulteti i Edukimit, 18 respondentë nga Fakulteti Ekonomik, 13 respondentë nga Fakulteti i Filologjisë, 10 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, 10 respondentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe 13 respondentë nga Fakulteti Juridik. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit.







### Rekomandimet e KSC-së në nivel të njësive akademike:

- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
- Fakulteti Ekonomik:
  1. Të krijohen kushtet të volitshme për pjesëmarrje dhe organizim të ekspertizave.
- Fakulteti i Filologjisë:
  1. Personeli akademik rekomandohet të kontribuojë në komisione, grupe punuese, dhe të merr pjesë në mënyrë vullnetare në punë në komunitet.
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: nuk ka
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: nuk ka
- Fakulteti Juridik:
  1. Komisioni duhet të bëjë vlerësimin në këtë jesë në përputhje me formularët A4 dhe A5.

## 7. Vlerësimi gjithëpërfshirës (shtojca A.6.)

Pyetëtori është i destinuar për studentët. Vlerësimi gjithëpërfshirës është hartuar me qëllim që të siguroj një informacion gjithëpërfshirës nga studentët. Pyetëtori është i ndarë në 4 shtylla/kategori për vlerësim me 32 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura.


- Kategoria e programit studimor përmban 7 pyetje,
- Kategoria e fakultetit, qeverisjes dhe shërbimeve për studentë përmban 7 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur,
- Kategoria për shërbimet administrative të universitetit përmban 3 pyetje,
- Kategoria e bibliotekës përmban 7 pyetje,
- Kategoria e infrastrukturës përmban 4 pyetje,
- Kategoria e aktiviteteve jashtë kurrikulare përmban 4 pyetje.

Pyetjet kanë qëllim të ofrojnë outpute në aspektet:


- Sa i përmbush programi studimor pritshmëritë e studentëve,
- Mjaftueshmërinë e lëndëve zgjedhore,
- Motivimin për punë kërkimore shkencore të studentëve,
- Programi studimor dhe punësimi,
- Korrelacioni menaxhment-student,
- Funkcionaliteti i fakulteteve, shërbimeve studentore,
- Raportet ndërpersonale,
- Zgjedhjet studentore,
- Mobiliteti,
- Informimi, shërbimet e IT-së,
- Biblioteka, qasja, literatura, shërbimi,
- Infrastruktura, sallat, kabinetet, paisjet laboratorike, higjiena.

Vlerësimi bëhet nga 1-5. Pyetëtori është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Numri i studentëve që iu janë përgjigjur plotësisht të pyetësorit sipas programeve të studimit janë si në vijim: 104 respondentë nga drejtimi Administrim Biznesi dhe Menaxhment, 408 respondentë nga drejtimi Juridik, 157 studentë nga drejtimi Software Design, 143 respondentë nga drejtimi TIT, 53 respondentë nga drejtimi master Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, 175 respondentë nga drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 225 respondentë nga drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Angleze, 139 respondentë nga drejtimi Gjuhë Gjermane, 53 respondentë nga drejtimi Agrobiznes, 44 respondentë nga drejtimi Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit, 15 respondentë nga drejtimi master Menaxhim në Agrobiznes, 218 respondentë nga Programi Fillor, 222 respondentë nga Programi Parashkollor, 42 respondentë nga Programi Fillor (gjuhë boshnjake), 16 respondentë nga Programi Parashkollor (gjuhë boshnjake), 24 respondentë nga Programi Parashkollor (gjuhë turke), 33 respondentë nga Programi Fillor (gjuhë turke), 62 respondentë nga drejtimi TIT (gjuhë boshnjake), 15 respondentë nga drejtimi TIT (gjuhë turke). Në total janë 6107 respondentë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësorët.


Programi studimor i përmbush pritjet e studentëve.




Programi studimor ofron numër të mjaftueshëm të lëndëve zgjedhore.




Puna praktike zhvillohet rregullisht dhe sipas planifikimit.




Studentët motivohen për t'u përfshirë në punën kërkimore në bashkëpunim me mësuesin.




Studentëve i ofrohen shërbime dhe këshilla nga bartësit e programit studimor.




Studentëve i ofrohet mësimi elektronik (ligjeratat online).




Programi studimor i ofron studentëve mundësinë e punësimit pas përfundimit të studimeve.




Menaxhmenti i fakultetit (dekani, prodekani, shefi i programit) është i hapur për vërejtje, sugjerime dhe kërkesa të studentëve.




Fakulteti ka staf të mjaftueshëm dhe funksionon në mënyrë efikase.




Shërbimet e administratës së fakultetit janë të kënaqshme.




Fakulteti ofron kushte infrastrukturore të kënaqshme (p.sh. ndërtesa, klasa, laboratore, hapësira sociale).




Raportet mësimdhënës-student janë miqësore dhe motivuese.




Studentët marrin pjesë në zgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve të Parlamentit Studentor (PS).




Studentëve i ofrohen mundësi për mobilitet dhe intership jashtë vendit (p.sh. Erasmus).




Administrata ofron shërbime efikase për studentët.




Shpalljet dhe njoftimet për studentë jepen me kohë.






Personeli i IT-së ofron shërbime efikase për studentët.




Biblioteka ka personel të mjaftueshëm dhe profesional.









Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme në gjuhët e komuniteteve (Boshnjakisht, Turqisht).




Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme në gjuhët e huaja. (Anglisht, Gjermanisht).




Biblioteka ofron qasje dhe shërbime të kënaqshme për personat me nevoja të veçanta.




Në Fakultet/Universitet kemi hapësira të mjaftueshme.




Sallat e mësimit ofrojnë kushte të kënaqshme për mësim.




Mirëmbajtja e hapësirave të Fakultetit/Universitetit është në nivelin e duhur.




Kabinetet e informatikës janë të pajisura me kompjuterë dhe IT-ja pajisje dhe të njejtat janë në dispozicion për studentët.





Studentët marrin pjesë në planifikimin dhe vendimmarrjen e aktiviteteve jashtëkurrikulare.



Studentët kanë qasje në qendrat rekreative, argëtuese dhe sportive brenda ose jashtë Universitetit.





### **Komentet e studentëve:**

Shumica kanë dhënë komente pozitive. Megjithatë, disa nga kritikët e studentëve janë renditur si më poshtë:

- Të informohen më shumë për lëndë zgjedhore para përzgjedhjes,
- Rritja e programeve në gjuhën turke,
- Programi i gjuhës shqipe të mos jetë 3-vjeçar,
- Të minimizohet përdorimi i sllajdeve,
- Në Fakultetin Juridik të bëhet më shumë praktikë,
- Të ketë më shumë hapësirë për studentë në Fakultetin e Edukimit,

- Të ofrohet më shumë punë praktike në programin Administrim Biznesi
- Të përmirësohen më tej kushtet infrastrukturore,
- Të ketë më shumë aktivitete.

### **Rekomandimet nga KSC në nivel të njësive akademike:**

- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
- Fakulteti Ekonomik:
  1. Të shfrytëzohen hapësirat aktuale për punë praktike në fakultet (kabinetet, sallat për projekte).
  2. Zgjedhjet studentore të shpallen në fillim të vitit akademik në mënyrë që edhe studentët e rinj të marrin pjesë në zgjedhje dhe të jenë më aktiv.
- Fakulteti i Filologjisë: Nuk ka rekomandime.
  1. Studentët janë shprehur mjaft të kënaqur me programet e studimit, kushtet për studime dhe komunikim me stafin akademik.
- Fakulteti Shkencave të Jetës dhe mjedisit:
  1. Rekomandohet Menaxhmenti i FSHJM-së që të shtoj bashkëpunimin me ndërmarrjet publike dhe kompanitë private, me qëllim shtimin e mundësive për punësim të studentëve që mbarojnë studimet në FSHJM.
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
- Fakulteti Juridik: Nuk ka!


## **8. Vlerësimi i përformancës së dekanit (shtojca A.7.)**

Pyetësi është i destinuar për stafin akademik me ç'rast vlerësohet dekanin e njësive përkatëse akademike. Vlerësimi i performancës së dekanit nga ana e stafit akademik realizohet një herë në vit. Pyetësi përmban 13 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur. Qëllimi i pyetësit është vlerësimi i aspekteve të përformancës së Dekanit si:


- vizioni dhe zhvillimi i njësive akademike;
- qëverisja dhe vendimmarrja;
- motivimi dhe mbështetja në punë kërkimore-shkencore;
- diskutimet në kuadër të njësive akademike;
- aftësitë e përfaqësimit brenda dhe jashtë universitetit;

Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Vlerësimi bëhet nga 1-5. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit.


Vlerësimi i janë përgjigjur 68 respondentë nga 6 njësitë akademike që veprojnë në universitet. Sipas të dhënave, 12 respondentë janë përgjigjur nga Fakulteti i Edukimit, 10 respondentë nga Fakulteti Ekonomik, 11 respondentë nga Fakulteti i Filologjisë, 6 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, 23 respondentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe 6 respondentë nga Fakulteti Juridik. Rezultatet e pyetësit “Vlerësimi i performancës së dekanit” sipas pyetjeve është si në vijim:




### 1. Si e vlerësoni mundësinë qasjes te Dekani në fakultet



### 2. Si e vlerësoni dekanin në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e mësimit brenda fakultetit




### 3. Si e vlerësoni dekanin në motivimin dhe mbështetjen e punës kërkimore-shkencore në fakultet







#### 4. Si e vlerësoni suksesin e Dekanit në mentorimin dhe zhvillimin e fakultetit




#### 5. Si e vlerësoni Dekanin në sigurimin e pjesëmarrjes së fakultetit në vendimmarrje dhe qeverisjen e Universitetit




#### 6. Si e vlerësoni drejtësinë e Dekanit në shpërndarjen e burimeve/resurseve




### 7. Si e vlerësoni qasjen e Dekanit në diskutimin e çështjeve shqetësuese të fakultetit




### 8. Si do ta vlerësonit Dekanin në ndarjen e hapësirës midis departamenteve




### 9. Si e vlerësoni përfaqësimin e Dekanit në Universitet




### 10. Si e vlerësoni përfaqësimin e Dekanit në komunitetin e jashtëm




### 11. Si e vlerësoni suksesin e Dekanit në sigurimin e burimeve (paga, pajisje etj.) nga menaxhmenti i lartë



### 12. Si e vlerësoni vizionin e Dekanit për zhvillimin e fakultetit





**Rekomandimet e KSC-së në nivel të njësive akademike nga rezultatet e vlerësimit të pyetësorit A.7:**

- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
- Fakulteti Ekonomik:
  1. Dekani duhet të motivoj dhe mbështesë stafin akademik për punën e tyre kërkimore – shkencore dhe të ketë një vendimarrje transparente me gjithë stafin.
  2. Dekani të jetë më aktiv në trajtimin dhe shqyrtimin e qështjeve të fakultetit, të ndërtoj ura komunikimi dhe bashkëpunimi me gjithë stafin.
- Fakulteti i Filologjisë: Nuk ka!
- Fakulteti i Shkencve të jetës dhe Mjedisit:
  1. Dekani i FSHJM-së të jetë më aktiv në raport me të gjitha detyrat që është vlersuar me notën nën 4.
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
- Fakulteti Juridik: Nuk ka!

## **9. Vlerësimi nga studentët e diplomuar (shtojca A.8)**

Pyetësi përdoret nga studentët e diplomuar në nivelin baçelor dhe master, për secilin program studimor. Pyetësi përmban 41 pyetje, 38 prej të cilave janë të mbyllura dhe 3 pyetje të hapura. Pyetësi është i ndarë në tri shtylla/kategori :

- Programi studimor,
- Mësimdhënia dhe vlerësimi,
- Trajtimi i studentëve dhe mbështetja e mësimit,
- Vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve

Qëllimi i pyetësit është të mbledh informacione lidhur me përmbajtjen e programit, koherencën e programit ndër vite, pritshmëritë, mësimdhënien, ushtrimet, punën praktike, përfshirjen e studentëve në punë kërkimore, mobilitetin, vlerësimin, afatet e provimeve, raportet mësimdhënës-student, konsultimet, mentorimin, zyrën për karrierë dhe alumni, përgatitjen profesionale gjatë studimeve, ECTS-të, pritjet nga programi, dobësitë, pikat e forta etj. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit.

## **10. Vlerësimi nga stafi akademik**

### **10.1. Vlerësimi nga stafi akademik (shtojca A.9.)**


Pyetësi përdoret nga stafi akademik i universitetit dhe realizohet një herë në vit. Pyetësi përmban 59 pyetje, prej të cilave një pyetje është e hapur. Pyetësi është i ndarë në tri shtylla/kategori:

- Menaxhimi dhe pjesëmarrja
- Puna kërkimore – shkencore
- Infrastruktura


Qëllimi i pyetësit është të siguroj informacione rreth institucionalizimit, transparencës në universitet, pjesëmarrjes në vendimarrje, kriteret dhe promovimin akademik, përpjekjet për inovacion, sigurim të cilësisë, misionin dhe vizionin e universitetit, objektivat strategjike, ndërkombëtarizimin, avancimin profesional, numrin e studentëve, syllabuset, ECTS-të, mobilitetin, drejtuesit e njësive akademike, komunikimin staf akademik/student/staf administrativ, shërbimet e bibliotekës, bashkëpunimin për punë kërkimore – shkencore, trajnimet, projektet, aktivitetet jashtë kurikulare, infrastrukturën, higjienën, shërbimet IT, mjetet e komunikimit, web faqen etj. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit.


Pyetësit i janë përgjigjur 68 respondentë në nivel universiteti. 12 respondentë janë nga Fakulteti i Edukimit, 9 respondentë nga Fakulteti Ekonomik, 12 respondentë nga Fakulteti i Filologjisë, 6 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, 22 respondentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe 7 respondentë nga Fakulteti Juridik. Në nivel universiteti, shtylla/kategoria “Menaxhimi dhe pjesëmarrja” është vlerësuar me 4,2 e cila paraqet një rezultat mjaft të lartë. “Puna kërkimore” është vlerësuar me 3,7, e cila paraqet një rezultat mbi mesataren. “Infrastruktura” është vlerësuar me 3,7, e cila po ashtu është mbi mesataren.




### 1. Si e vlerësoni nivelin e institucionalizimit të Universitetit




### 2. Si e vlerësoni transparencën dhe përgjegjshmërinë e vendimeve të Senatit dhe Këshillit Drejtues të Universitetit




### 3. Si e vlerësoni transparencën dhe përgjegjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Fakultetit, Dekanatit, Zyrtarëve të Menaxhmentit




#### 4. Si e vlerësoni mundësinë tuaj për pjesëmarrje në vendimmarrje menaxheriale të Universitetit dhe njësisë akademike



#### 5. Si e vlerësoni lirinë e të shprehurit




#### 6. Si i vlerësoni kriteret dhe procedurat e emërimit dhe promovimit akademik







### 7. Si i vlerësoni përpjekjet për inovacion, ndryshim dhe përmirësim të cilësisë




### 8. Si e vlerësoni përshtatshmërinë e fushës tuaj profesionale dhe njësisë akademike




### 9. Si e vlerësoni përcaktimin e objektivave dhe performancës të njësisë akademike




### 10. Si e vlerësoni misionin dhe vizionin e Universitetit?




### 11. Si i vlerësoni prioritetet dhe objektivat strategjike të Universitetit?




### 12. Si i vlerësoni objektivat dhe përpjekjet për ndërkombëtarizim të Universitetit?




13. Si e vlerësoni pozitën e Universitetit tonë në raport me universitetet tjera në vend




14. Si i vlerësoni marrëdhëniet e Universitetit me institucionet e jashtme (institucionet publike, private, OJQ-të, publikun...)?




15. Si e vlerësoni mundësinë e avancimit akademik/profesional dhe kompensimin tuaj financiar




### 16. Si e vlerësoni numrin e studentëve në programin tuaj studimor?




### 17. Si i vlerësoni shkathtësitë e studentëve në fakultetin tuaj




### 18. Si e vlerësoni përputhshmërinë e syllabusit, përmbajtjen e lëndëve dhe kredit ECTS




### 19. Si e vlerësoni numrin e stafit akademik në fakultetin tuaj









### 20. Si e vlerësoni cilësinë dhe kompetencën e stafit akademik në fakultetin tuaj






### 21. Si e vlerësoni interesimin e studentëve të huaj për studime në Universitet














[Si i vlerësoni politikat dhe masat nxitëse për punë kërkimoro-shkencore në Universitet?]




[Si e vlerësoni përkrahjen e Universitetit\ fakultetit, për pjesëmarrje në kongrese, konferenca dhe punëtori ndërkombëtare?]




[Si i vlerësoni programet e Universitetit për trajnime të mësimdhënësve?]




[Si e vlerësoni përkrahjen e Universitetit në hartimin dhe dizajnimin e projekteve kërkimoro-shkencore?]




[Si e vlerësoni zbatimin dhe përkrahjen e projekteve nga jashtë në punën kërkimore?]




[Si e vlerësoni mjaftueshmerinë e programeve të mobilitetit (Erasmus+ etj.)?]




[Si e vlerësoni kushtet për aktivitete kulturore dhe artistike në Universitet?]









[Si i vlerësoni aktivitetet sportive dhe hapësirat e krijuara për këtë qëllim?]




[Si e vlerësoni higjenën në kampus?]









[Si i vlerësoni shërbimet me mjetet e komunikimit (posta, posta elektronike, njoftimet etj.)?]






[Si e vlerësoni përmbajtjen dhe dizajnin e uebfaqes së Universitetit?]




[Si e vlerësoni përmbajtjen e faqes së njësive akademike në internet?]







[Si e vlerësoni mjaftueshmërinë e pajisjeve në zyrë (kompjuter, printer, inventar)?]



[Si e vlerësoni mjaftueshmërinë e personelit administrativ dhe personelit ndihmës në Universitetet dhe njësisë akademike?]




[Si e vlerësoni kualifikimin e stafit administrativ dhe stafit ndihmës?]







[Në çfarë mase përputhen pritshmëritë tuaja me gjendjen aktuale në Universitet?]



[Në çfarë mase përputhen pritshmëritë tuaja me gjendjen aktuale në njësinë akademike?]



[Sa jeni të kënaqur me punën dhe kontributin tuaj në Universitet?]



Komentet nga pyetësi:

- Fakulteti i Edukimit:
  1. Ka mungesë të kuadrit administrativ, përkatësisht duhet forcuar shërbimin e studentëve me staf shtesë.
  2. Duhet siguruar zgjerimin e hapësirës për mësim, ushtrime dhe punë praktike dhe profesionale.
  3. Duhet krijuar kushtet infrastrukture (urgjentisht), rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së kushteve të përgjithshme dhe të cilësisë së studimit.
  4. Avancimi i web faqës, informatat rreth FE (pjesëmarrja e studentëve, sigurimi i materialeve të studimit për nevojat e programeve studiuuese (Edukim)
  
- Fakulteti Ekonomik: Nuk ka!
  
- Fakulteti Filologjik: Nuk ka!
  
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit:
  1. Laboratorët duhet të jenë në funksion të plotë.
  
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
  
- Fakulteti Juridik:
  1. Të shtohet numri i paisjeve me mjete të punës siç janë kompjuterët dhe printerët.

### **Rekomandimet e KSC-së në nivel të njësisive akademike nga rezultatet e vlerësimit të pyetësit A.9**

Bazuar në rezultatet e pyetësit A9 rekomandohet:

- Të punohet në shtimin e kapaciteteve për avancim akademik/profesional dhe kompensim financiar.
- Të punohet për shtimin e numrin të stafit akademik në fakultet.
- Të punohet në shtimin e interesimit të studentëve të huaj për studime në UUHP.
- Të krijohen kushte më të favorshme dhe shërbime në bibliotekë me libra, revista, dokumente hulumtuese dhe baza të të dhënave.
- Të shtohet bashkëpunimi në mes stafit akademik në punën kërkimoro – shkencore.
- Të shtohet përkrahja e universitetit/fakultetit për pjesëmarrje në kongrese, konferenca dhe punëtori ndërkombëtare.
- Të punohet më shumë në programet e universitetit për trajnime të mësimdhënësve.



- Të punohet më shumë nga universiteti për përkrahjen në hartimin dhe dizajnimin e projekteve kërkimore – shkencore.
- Krijimin e mundësive, transparencës dhe përfshirjen e stafit në vendimmarrje, si dhe aplikimin dhe përshtatjen e metodave më të mira sa i përket rekrutimit të personelit.
- Të ofrohen kushte për mësimdhënie atraktive duke trajnuar stafin në metodat më të mira pedagogjike.
- Pajisjen e laboratoreve me aparatura dhe materiale shpenzuese që nevojiten për analizat e ndryshme gjatë hulumtimeve shkencore.
- Intensifikimin e punëve në zyrën e projekteve.
- Të pajisjet FSHJM-ja me laboratore të reja konform kurrikulës së programeve;
- Pajisjen e sallave mësimore me projektorë dhe kompjuterë që janë në funksion të punës sa më efektive;
- Pajisjen e profesorëve, gjegjësisht zyreve të tyre me kompjuterë dhe mjete të tjera përcjellëse.
- UUHP të krijojë kushte për sigurimin e transportit për studentë gjatë vizitave në terren.
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike:
  - Biblioteka e universitetit të pajiset me të gjithë librat që janë në syllabuset e lëndëve të FSHK-së në mënyrë që stafi akademik dhe studentët t'i kenë në dispozicion librat e nevojshëm.
  - Të rritet bashkëpunimi mes kolegëve për hulumtime shkencore.
  - Universiteti duhet të respektoj rregulloret në fuqi për kërkime shkencore dhe mos krijohen barrierat e pa nevojshme që të ndikojë në demotivimin e stafit akademik.
  - Trajnimet e stafit akademik duhet të organizohen së paku çdo semestër.

## **11. Vlerësimi nga stafi i administratës**


### **11.1. Vlerësimi nga stafi i administratës (shtojca A.10.)**

Pyetësi është i destinuar për stafin administrativ në nivel qendror dhe në njësi akademike. Pyetësi realizohet një herë në vit. Pyetësi përmban 45 pyetje të mbyllura dhe një pyetje të hapur. Qëllimi i pyetësit është identifikimi i dobësive dhe mangësive me qëllim të përmirësimit si në nivel qendror, poashtu edhe në nivel të njësive akademike. Pyetësi ka për qëllim vlerësimin e institucionalizimit të universitetit, transparencën, përgjegjshmërinë, mundësitë për vendimmarrje, detyrat/kompetencat, bashkëpunimin me staf administrativ, akademik, studentë, avancimin, ambientet e punës, lirinë e të shprehurit, përpjekjet për sigurim të cilësisë, ndërkombëtarizimin, menaxhmentin, infrastrukturën, sigurinë, shërbimet e bifesë, shërbimet e informimit/komunikimit, webfaqen, pritshmëritë etj.


Nga administrata qendrore në plotësimin e pyetësorit janë përgjigjur 14 respondentë, nga njësitë akademike 6 respondentë, në total 20 respondentë. Pyetësi vlerësohet nga 1-5. Rezultati i vlerësimit në total është 3,9, nga administrata qendrore vlerësimi është 3,2, përderisa vlerësimi nga njësitë akademike është 4.1. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e tabuluara nga pyetësorët.




[Si e vlerësoni transparencën dhe përgjegjshmërinë e vendimeve të Senatit dhe Këshillit Drejtues të Universitetit?]






[Si e vlerësoni transparencën dhe përgjegjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Fakultetit, Dekanatit, zyrtarëve dhe të menaxhmentit?]




[Si e vlerësoni mundësinë tuaj për pjesëmarrje në vendimmarrje menaxheriale të Universitetit dhe\ose në njësisë akademike?]







[Si e vlerësoni procesin e emërimeve të stafit administrativ duke marr parasysh kompetencën profesionale?]






[Si i vlerësoni kriteret e përzgjedhjes dhe procedurat e promovimit administrativ?]






[Si e vlerësoni sigurinë e ambientit të punës?]












[Si e vlerësoni misionin dhe vizionin e Universitetit? Nese vlerësoni me 1 dhe 2 shëno arsyeen!]




[Si i vlerësoni prioritetet dhe objektivat strategjike të Universitetit? Nëse vlerësoni me 1 dh 2 shëno arsyeen!]




[Si i vlerësoni objektivat dhe përpjekjet për ndërkombëtarizim të Universitetit? Nëse vlerësoni me 1 dh 2 shëno arsyeen!]




[Si e vlerësoni pozitën e Universitetit tonë në raport me Universitetet tjera në vend?]




[Si i vlerësoni marrëdhëniet e Universitetit me institucionet e jashtme (institucionet publike, private, OJQ-të, publikun...)?]




[Si e vlerësoni numrin e studentëve në Universitet?]




[Si e vlerësoni cilësinë dhe kompetencën e stafit akademik në raport me administratën?]









[Si e vlerësoni aplikimin për studime të studentëve të huaj në Universitet?]




[Si e vlerësoni kompensimin e punës jashtë orarit?]









[Si i vlerësoni kushtet për aktivitete kulturore dhe artistike në Universitet?]






[Si i vlerësoni mundësitë për aktivitete sportive dhe hapësirat e krijuara për këtë qëllim?]









[Si e vlerësoni higjenën në kampus?]















**Rekomandimet e KSC-së në nivel të njësive akademike dhe në nivel të administratës qendrore:**

- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
- Fakulteti Ekonomik: Nuk ka!
- Fakulteti i Filologjisë: Nuk ka!
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: Nuk ka! (shënim për shkak të lëvizjes së stafit administrativ në nivelin qendror, të dhënat për pyetëtorin A10 mungojnë).



- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!.
- Fakulteti Juridik: Nuk ka!.
- Për administratë qendrore:
  1. Të organizohen trajnime për stafin administrativ sipas nevojës.
  2. Të organizohen takime dhe evente me qëllim të rritjes së socializimit brenda stafit.
  3. Të rekrutohet staf në administratën e universitetit duke plotësuar pozitat e lira.
  4. Të specifikohen saktë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës në universitet.
  5. Të hartohet rregullore e brendshme përmes së cilës do të rregullohet orari i punës dhe kompensimi i punës jashtë orarit.
  6. Të rritet bashkëpunimi i universitetit me institucionet dhe organizatat e fushës përkatëse me qëllim të pasurimit të jetës kulturore e artistike.
  7. Të shfrytëzohen në maksimum mjetet e planifikuara për qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së sniversitetit.
  8. Të investohet më tej në infrastrukturën e IT-së.
  9. Të rekrutohet staf administrativ për mirëmbajtjen e webfaqes së sniversitetit.
  10. Të ftohet operatori për zgjerim të menysë së byfesë, si dhe të kërkohet përmirësim i shërbimeve për personel dhe studentë.
  11. Të sigurohet që shërbimet e servisimit të jenë më të frekuentuara nga operatorët e kontraktuar.
  12. Të mbështeten aktivitetet e organizuara nga Federata Sportive e Universiteteve si dhe çdo iniciativë e cila plotëson kërkesat reale për ativitete të kësaj natyre.
  13. Të rishikohen politikat e universitetit për studentët e huaj.
  14. Të stimulohen studentët nga Shqipëria si dhe vendet tjera të regjionit.

## **12. Vlerësimi nga Bordi Këshilldhënës Industrial (BKI)**


### **12.1. Vlerësimi nga BKI (shtojca A.11.)**

Pyetëtori është i destinuar për punëdhënësit, gjegjësisht BKI-të dhe realizohet një herë në vit. Pyetëtori përbëhet nga 14 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur. Qëllimi i pyetësit është rritja e bashkëpunimit me sektorin e biznesit, vlerësimi i bashkëpunimit me universitet/njësitë akademike, nevojat e punëdhënësve, puna praktike, komunikimi me universitet/njësit[ akademike, participimi i BKI-së në procesin mësimor, rëndësia e bashkëpunimit, pjesëmarrja në strukturat e universitetit / njësive akademike. Pyetëtori është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.


Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetëtorët. Pyetëtorit i janë përgjigjur 29 respondentë në total. 9 respondentë janë nga Fakulteti i Edukimit, 7 nga Fakulteti i Filologjisë, 6 nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, 2 nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe 5 nga Fakulteti Juridik. Rezultatet e vlerësimit nga 1-5 në nivel universitar është 4.1. Fakulteti i Filologjisë është vlerësuar me 4.1, Fakulteti i Edukimit 3.4, FSHK me 4.7, FSHJM me 4.3, Fakulteti Juridik me 4, përderisa për Fakultetin Ekonomik nuk ka të dhëna për plotësim të pyetëtorit.




[Faza më e rëndësishme është krijimi i formës së bashkëpunimit me Universitetin përmes inicimit të kontakteve me stafin adekuat të Universitetit.]




[Universiteti/fakultetet janë të hapur për bashkëpunim me palët e jashtme të interesit.]




[Ekziston një mekanizëm i qartë dhe transparent i përfshirjes së punëdhënësve në procesin mësimor.]




Universitetin, Fakultetin, Stafin, Studentet [Nevojat e punëdhënësve janë shumë të rëndësishme për hartimin e programeve të reja dhe rishikimin e programeve ekzistuese.]




[Ekziston një sistem efikas, i mirë i organizuar i punës praktike për studentë, me përfshirjen e akterëve të jashtëm të interesit.]




[Punëdhënësit janë të informuar me kanalet e komunikimit me stafin akademik dhe udhëheqësit e programeve.]




[Ekzistojnë trupa formale ku palët e jashtme të interesit janë pjesëmarrës në strukturat menaxhuese të Universitetit. Ndikimi dhe rëndësia e këtyre trupave zyrtare në aktivitetet e Universitetit.]



[Qasja e autoriteteve të Universitetit për bashkëpunim me punëdhënësit është adekuate.]




[Qasja e punëdhënësve për bashkëpunim me Universitetin është adekuate.]







[Participimi direkt i përfaqësuesve të punëdhënësve në procesin mësimor (thirrje për mbajtjen e një ligjërata në lëndën, ligjërata publike, identifikimi e temave të diplomave) është adekuate.




[Punëdhënësit shohin përfitim afatgjatë prej bashkëpunimit me Universitetin dhe ndikimi i këtij bashkëpunimi reflektohet në shkathtësitë dhe kompetencat e të diplomuarve.]



[Stafi akademik e vlerëson rëndësinë e bashkëpunimit me punëdhënësit.]





### Rekomandimet e KSC në nivel të njësive akademike:

- Fakulteti i Edukimit:
  1. Duhet të përforcohet bashkëpunimi i fakultetit me palët e jashtme të interesit për të reflektuar në shkathtësitë dhe kompetencat e të diplomuarve,
  2. Në bashkëpunim me palët e interesit, të punohet në formimin e një mekanizmi të qartë dhe transparent të përfshirjes së punëdhënësve në procesin mësimor,
  3. Të përforcohet bashkëpunimi lidhur me participimin direkt të përfaqësuesve të punëdhënësve në procesin mësimor (thirrje për mbajtjen e një ligjërate, ligjërata publike, identifikimin e temave të diplomave) është adekuate.
- Fakulteti i Filologjisë: Nuk ka!
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: Nuk ka!
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
- Fakulteti Juridik: Nuk ka!


## 13. Monitorimi i braktisjes së studentëve

### 13.1. Rezultatet e monitorimit të braktisjes së studentëve (shtojca A.12.)

Pyetësi është i destinuar për studentët të cilët ç'regjistrohen në nivelet baçelor dhe master, në të gjitha programet studimore. Pyetësi realizohet gjatë fazës së ç'regjistrimit të studentit me qëllim të mbledhjes së informacioneve për arsyet e tërheqjes nga studimet dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe parandalimit të tërheqjes së studentëve nga studimet. Pyetësi është i ndarë në tre kategori dhe nënkategori:

- Arsye personale
- Migrimi
- Arsye në lidhje me programin/lëndën/fakultetin
- Mungesa e studimeve me korespondencë
- Ndërrim i fakultetit
- Punësimi
- Arsye financiare
- Studime jashtë shtetit
- Të tjera

Pyetësi po ashtu përfshin edhe dy pyetje të hapura. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit. Nga rezultatet e fituara shihet se arsyeja kryesore e braktisjes është migrimi në 57% të rasteve të deklaruara, e më pas me 15% kanë deklaruar arsye personale, 6% arsye financiare dhe punësimi, 5% mungesë e kohës për studime, 4% studime jashtë shtetit, 3% ndërrim i fakultetit, 1% ndërrim i universitetit dhe të tjera 1%.



## 14. Vëzhgimi ndërkolegial i orës mësimore

### 14.1. Rezultatet e vëzhgimit ndërkolegial të orës mësimore (shtojca A.13.)

Vlerësimi ndërkolegial i orës mësimore realizohet dy herë në vit, çdo semestër. Vëzhgimi ndërkolegial bëhet në lëndën apo lëmin e njëjtë ose të përafërt. Qëllimi i pyetësorit është :

- të identifikohen pjesët e ligjëratës që e përmirësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies
- sygjerimet lidhur me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies ku poashtu shkruhen vëzhgimet, idetë, objektivat gjatë procesit të vëzhgimit.

Në Fakultetin e Edukimit janë kryer 10 vëzhgime kolegjale, në Fakultetin Ekonomik 18 vëzhgime kolegjale, në Fakultetin Filologjik 10, në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit 2 vëzhgime kolegjale, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike 13 vëzhgime kolegjale, në Fakultetin Juridik 1 vëzhgim kolegjial.

Rekomandimet e KSC në nivel të njësive akademike


- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
- Fakulteti Ekonomik: Nuk ka!
- Fakulteti i Filologjisë:
  1. Të përdoren video e materiale digjitale nga folës burimor të gjuhës angleze,
  2. Të vazhdojë me të njëjtën tempo me vitet e tjera në vijim,
  3. Rr.R. është një nga mësimdhënëset e reja që premtan shumë në ngritjen e cilësisë akademike dhe do t'i jep universitetit një vlerë të shtuar në renditjen botërore.
  4. Rekomandimi i literaturës shtesë, ndërlihdja me njësinë paraprake,
  5. Procesi i ushtrimeve ishte në nivel të kënaqshëm dhe çdo gjë ishte ne rregull.
  6. Përgatitja e materialeve shtesë – për studentët e avancuar, por edhe ata të nivelit më të ulët.
  7. Të vijojë të mbajë orët e ligjëratave kështu dhe aty ku sheh që duhet të ndryshojë për më mirë ndonjë pjesë të ligjëratës, le ta bëjë.
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit,
  1. Trajnime që kanë për bazë metodat e mësimimit me studentin në qëndër.
- Fakulteti Juridik:
  1. Komisioni rekomandon të gjithë stafin që në të ardhmen të përmbushet pyetësori A13 që ka të bëjë me vlerësimin kolegjial.




## 15. Vetëvlerësimi i mësimdhënësve




### 15.1. Rezultatet e vetëvlerësimit të mësimdhënësve (shtojca A.14.)




Pyetësi për vetëvlerësimin e mësimdhënësve realizohet 1 herë në vit nga stafi akademik i universitetit. Pyetësi përmban 21 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura. Qëllimi i pyetësit është identifikimi i anëve pozitive dhe përmirësimeve që duhet të bëhen. Pyetësi përfshin pyetje rreth potencialit të shfrytëzuar, respektimit të orarit dhe bashkëpunëtorëve, pritshmërive, kohës së dedikuar hulumtimeve, vlerësimit të studentëve, teknikave të mësimdhënies, burimeve për ligjëratat, pjesëmarrjes në konferenca/trajnime, mentorimit, kontributit në zhvillim të kurrikulave, programit studimor etj.

Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit. Pyetësit i janë përgjigjur 61 respondentë. 11 respondentë janë nga Fakulteti i Edukimit, 9 respondentë nga Fakulteti Ekonomik, 9 respondentë nga Fakulteti i Filologjisë, 6 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, 19 respondentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe 7 respondentë nga Fakulteti Juridik. Mësimdhënësit në universitet janë vetëvlerësuar me notë 4,7. Fakulteti i Edukimit me notë 4,8, Fakulteti Ekonomik me notë 4,8, Fakulteti i Filologjisë me notë 4,9, Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit me 4,7, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me 4,7 dhe Fakulteti Juridik me 4,3.
























[Bashkëpunoj me kolegët për të identifikuar dhe zgjidh problemet e të mësimdhënies dhe mësimnxënies.]




[Marr pjesë aktive ne zhvillimin e kurrikulave.]




[Marr pjesë në konferenca, trajnime, kongrese, punëtori... dhe i përdori njohuritë e reja në mësimdhënie.]




[Marr pjesë në konferenca, trajnime, kongrese, punëtori... dhe i përdori njohuritë e reja në mësimdhënie.]




[Sa jeni të kënaqur me mentorimin tuaj dhe këshillat akademike që kontribuojnë në zhvillimin profesional, hulumtues dhe kreative të studentëve.]



[I involvojë studentët në punën time hulumtuese.]





### **Komentet nga stafi akademik jam i mirë në, janë:**

Veprimtaria ime mësimore është e strukturuar si vijon:

- motivimi, kreativiteti, qëllimet dhe objektivat pedagogjike, veprimtaria pedagogjike, mjetet dhe metodat pedagogjike për zgjidhjen e problemeve përmes hulumtimeve të caktuara, konsultimi i vazhdueshëm i literatures moderne, përkushtimi i qartë për algoritmin për formimin e kompetencave të studentëve dhe të diplomuarve të Fakultetit të Edukimit.
- Organizimi i mësimit, menaxhimi, bashkëpunimim ndërkolegial,
- Në mësimdhënie dhe bashkëpunim ndërkolegial, bashkpunimin me studentë.
- Angazhimin dhe punën shkencore, bashkëpunimin me studentë.
- Mësimdhënie, komunikim me studente dhe angazhime ne fakultet.
- Komunikim me studentët, identifikimin dhe propozimin e literaturës për shqyrtim e hulumtim nga studentët, organizimin e orës mësimore interaktive dhe të udhëhequr nga studentët.
- Inkorporimin e metodave dhe teknikave më të reja në mësimdhënie.
- Përgatitje, organizim, përkushtim, zhvillim. Komunikim, bashkëpunim, kërkime dhe sjellje. Ligjërime dhe transmetim të dijes!
- Komunikim, krijimin e raporteve ndërnjerëzore dhe sociale, mundohem të ndihmojë gjithë ata që kanë nevoja. Hulumtime dhe mësimdhënie.
- Menaxhim, mësimdhënie, punë hulumtuese – kërkimore, punë në ekip etj.
- Shpjegimin dhe sqarimin e detajuar të proceseve – në mësimdhënie dhe mësim laboratorike. Menaxhim të punëve.
- Mësimi interaktiv, shumë shembuj konkret, studime të rasteve, implementime të programeve.
- Marrëdhëniet në mes të studentëve dhe kolegëve dhe futja e risive në.
- Elaborimin e problemeve teorike duke përdorur praktikën.

- Ligjerim, komunikim dhe bashkëpunim me studentët.
- Organizimi dhe planifikimi dhe klasa interesante dhe tërheqëse. Menaxhimi i kohës; marrëdhënie ndërpersonale me studentët e mi; mësimdhënësi lehtësues produktiv dhe motivues. Mentor profesional dhe jetësor.
- Ligjërime – komunikim. Ndjek performancat në mënyrën më të mirë të mundshme të adresuar nga UUPZ dhe Fakulteti Juridik.

#### **Komentet nga stafi akademik në pyetjen duhet të bëjë përmirësim në, janë:**

- Si mësimdhënës universitar nuk jam vetëm një pedagog që mëson studentët, por gjithashtu një studiues që kryen dhe duhet kryer më shumë punë shkencore. Për këtë qëllim, është e rëndësishme strukturimi menaxherial, zhvillimi profesional i vazhdueshëm, duke forcuar kompetencën dhe nivelin e profesionalizmit. Kushtet në të cilat punojmë. Që të kemi më shumë klasa të lira dhe kohë për të krijuar dhe mësuar më mirë.
- Punime shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca, hulumtimet shkencore. Në të gjitha. Ata që mendojnë që i dinë të gjitha janë ata që dinë më së paku. Të punojmë më shumë në punime shkencore.
- Të merrem më tepër me hulumtime në fushën e pyjeve dhe resurseve pyjore. Pjesëmarrje në konferenca dhe trajnime në gjuhën angleze. Përdorimin e aparaturave të reja për hulumtime në fushën e ekotoksikologjisë.
- Shtim të rasteve praktike. Të vazhdojmë në këtë format të vlerësimit e vetëvlerësimit.

#### **Rekomandimet e KSC në nivel të njësive akademie janë:**

- Fakulteti i Edukimit: Nuk ka!
- Fakulteti Ekonomik: Të ketë një bashkëpunim më të lartë të personelit akademik me kolegët dhe studentët!
- Fakulteti i Filologjisë: Nuk ka!
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: Trajnime që kanë për bazë metodat e mësimin me studentin në qëndër. Motivim më i madh i mësimdhënësve në lidhje me mundësitë për hulumtim ku përfshihen pajisjet për zyrë, literatura, pajisjet laboratorike, materialet shpenzuese laboratorike, aparaturat e nevojshme e pastaj edhe mbështetjet financiare pas botimeve.
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
- Fakulteti Juridik: Komisioni rekomandon stafin akademik që në të ardhmen t'i kushtojnë rëndësi plotësisht të pyetësorit që ka të bëjë me vetëvlerësimin e mësimdhënësve.

## **16. Plani i zhvillimit profesional të mësimeve/asistentit**

### **16.1. Plani i zhvillimit profesional të mësimeve/asistentit (shtojca A.15.)**

Pyetësi është i destinuar për stafin akademik. Duke synuar sigurimin e cilësisë në procesin e mësimeve dhe mësimit, universiteti është angazhuar të mbështesë zhvillimin profesional të të gjithë mësimeve dhe asistentëve përmes trajnimit dhe formimit, caktimit të detyrave që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive dhe fitimin e përvojës, krijimit dhe shkëmbimit të njohurive duke mësuar të tjerët dhe duke nxënë njëkohësisht.

Pyetësi përmban:

- Kërkesat e mësimeve dhe asistentëve për trajnim dhe mundësi për zhvillim profesional;
- Rekomandimet e Komisioni Qëndror për Sigurimin e Cilësisë për trajnim dhe zhvillim profesional në bazë të rezultateve të vlerësimit.

Pyetësit iu janë përgjigjur 25 respondentë, nga Fakulteti i Edukimit 5 respondentë; nga Fakulteti Ekonomik 6 respondentë; nga Fakulteti Filologjik 2 respondentë, nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit 5 respondentë; nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike 1 respondent; nga Fakulteti Juridik 6 respondentë.

#### **Komentet në Fushat për zhvillim profesional (trajnimi ose zhvillimi i veçantë që kërkohet).**

- Metodologji të reja të mësimeve. STATISTIKA – PROGRAMI SPSS. Aktivitetet e trajnimit gjatë shërbimit kanë një rëndësi të madhe për të siguruar zhvillimin e tyre profesional dhe personal, për t'u përshtatur me zhvillimet, për të rritur produktivitetin e tyre dhe për t'i përgatitur ata për pozicione më të larta. Është e nevojshme të ofrohet mbështetje e vazhdueshme për mësimeve në zhvillimin profesional për mësues të kualifikuar dhe mësimeve të kualifikuar.
- Metodatat dhe strategjitë e komunikimit bashkëkohor!
- Metodologji të avancuar të mësimeve. Pjesëmarrje në trajnime të ndryshme në lidhje me fushën e kontabilitetit!
- Pjesëmarrje në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare!
- Shtimi i aktiviteteve në punime hulumtuese – shkencore në fushën përkatëse së bashku me studentët. Pjesëmarrje në kongresin botëror WCOA 2022. Zhvillimi në praktikë i financave ndërkombëtare. Për trajnimet mbi qeverisjen e korporatave sidomos në vendet e tranzicionit, si e kanë kalur, sa ka dhënë rezultatet e duhura sistemi i qeverisjes së korporatave në këto vende duke krahasuar me vendet kapitaliste. Pastaj për ligjet e kompanive work shop ose trajnime mbi këtë fushë.

- Trajnime për asistentët në fusha të caktuara, ku mund të preket puna praktike në laboratorë. Përvetësimi i teknologjise në mësimdhënie, zhvillimi i softverit për testim online.
- Përdorim të sistemit Lin-Tab-TSAP, Dendrocronology. Biologji, Mjedis, Pyje. Përpunimit statistikor. Trajnim për identifikimin e insekteve dëmtuese të pyjeve dhe për metodologjite e reja mësimore në shkencat e natyrës!
- Shkrim akademik!
- Konferenca shkencore, bashkëpunimi me revista që janë të indeksuara në platforma me ndikim në shkencën ndërkombëtare, bashkëpunimi ndërkolegial dhe me studentë për avancimin e dijes dhe nivelit të ligjeratave etj. Metodologji në mësimdhënie. Mbështetje për vizita studimore në institucioneve të ndryshme, në fushen e të drejtave të njeriut.
- Aktivitete për të ftuar ligjërues të huaj brenda dhe jashtë Kosovës për tema të caktuara mbi lëndën.
- Organizimi i tribunave – takimeve për javën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- Të shtohen aktivitet në gupe me studentët për të promovuar të drejtat e njeriut. Zhvillimet e reja rreth metodologjisë së mësimdhënies dhe hulumtimeve shkencore. Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies. E Drejta Organizatave Ndërkombëtare/E Drejta Kushtetuese.

#### **Komentet për kërkesa:**

- Të mbahen trajnime shtesë për ngritje profesionale.
- Aktivitete të trajnimit në shërbim, Trajnim për kandidaturë të instruktorëve të emëruar për herë të parë, trajnime të trajnerëve ekspertë!
- Trajnime për Zhvillim Personal dhe Profesional, Trajnime Adaptimi për Instruktorë që Ndryshojnë Fushat në Programet universitare, pasuniversitare dhe doktoraturë, konferenca informative, panele, forume, simpoziume, etj. Këto janë trajnimet e organizuara për pedagogët në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit (MASHT).
- Pjesëmarrje në konferenca dhe punëtori që e intensifikojnë komunikimin e sotëm bashkëkohor.
- Të kemi trajnime për përmirësimin e teknikave të mësimdhënies dhe mësimnxenies. Shtimi i vizitave studimore së bashku me studentët në kompanitë e ndryshme të kontabilitetit dhe auditimit, instalimi i softuerëve të kontabilitetit në kabinetin e informatikës. Kërkojë nga KD të ma mundësojë pjesëmarrjen në kongresin botëror që do të mbahet prej datës 18-21 Nëntor 2022 në Mumbai – Indi. Pjesëmarrje në publikime shkencore dhe konferenca me studentë
- Organizimi i vizitave në BQK, banka komerciale dhe institucionet financiare tjera!
- Organizimi i vizitave në Institucionet Financiare Ndërkombëtare! Organizim të trajnimeve dhe seminareve në fushat kompetente!
- Kërkojë që mundësisht të më mundësohet një trajnim 1 javor, për përdorimin e sistemit LIN-Tab TSAP. Kërkojë që në kuadër të mundësive të ofrohet trajnim profesional lidhur



me përdorimin e aparaturave laboratorike. Trajnim në fushën e shfrytëzimit të pyjeve. Trajnim në fushën e pyjeve. Kërkesë që ekspertët e FAO-së apo ndonjë universiteti të mbajnë trajnim për shëndetin pyjor dhe mënyrat e identifikimit dhe luftimit të insekteve dëmtuese të pyjeve.

- Poashtu, kërkesë për trajnim në metodologjitë mësimore në shkencat e natyres, e sidomos ato laboratorike.
- Shkrim akademik!
- Stimulim material për komunikime akademike në rajon e më gjerë, përmes financimit të projekteve zhvillimore, tryeza, takime dhe puntori me institucionet profesionale në Kosovë siç janë; gjykatat, prokuroritë, odën e avokatëve, odën e ndërmjetësuesve, përmbaruesit dhe shërbimin sprovues për organizimin e trajnimeve në mësimdhënie. Shtimi i aktiviteteve, trajnimeve dhe kontributeve në komunitet në fushen përkatëse.
- Pjesëmarrja në trajnime dhe debate në organizata për të promovuar mbrojtjen ndërkombëtare për të drejtar e njeriut.
- Të shtojm aktivitetet për punime shkencore në fushën përkatëse dhe atë së bashku me studentët. Trajnim lidhur me zhvillimet e reja rreth metodologjise së mësimdhënies dhe hulumtimeve shkencore Kërkesë për trajnim lidhur me metodologjitë bashkohore të mësimdhënies. Për të drejtën e Organizatave ndërkombëtare - kërkohet vizita e studenteve në OSBE-në Kosovë, si dhe vizita te përfaqësuesit e zyres së BE-së në Kosovë.
- Të organizohen konferenca shkencore, bashkëpunimi me revista që janë të indeksuara në platforma me ndikim në shkencën ndërkombëtare, bashkëpunimi ndërkolegial me student avancimin e dijes dhe nivelit të ligjëratave si dhe stimulim material për komunikime akademike; të mbahen trajnime lidhur me metodologjitë bashkohore të mësimdhënies.

### **Rekomandimet e KSC-së në nivel të njësive akademike:**

- Fakulteti i Edukimit:
  1. Trajnime, seminare, punëtori, ku në focus kanë metodologjitë e reja të mësimdhënies,
  2. trajnime lidhur me metodologjitë e hulumtimit,
  3. Trajnime lidhur me mentorimin e temave të diplomave
  4. Sigurimi i vizitave studimore jashtë vendit
- Fakulteti Ekonomik: Nuk ka!
- Fakulteti i Filologjisë:
  1. Përvetësimi i teknologjisë në mësimdhënie, zhvillimi i sotverit për testim online.
- Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit :
  1. Trajnime që kanë për bazë metodat e mësimimit me studentin në qëndër.
  2. Trajnime të stafit akademik për përdorimin e aparaturave

## **Rekomandimet e përgjithshme të Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit**

- Rekomandojmë përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës në FSHJM. (Pajisjen e FSHJM me laboratore të reja konform kurrikulës në programet e FSHJM, me aparatura dhe materiale shpenzuese që nevojiten për analizat e ndryshme gjatë hulumtimeve shkencore;
- Pajisjen e sallave mësimore me kompjuterë që janë në funksion të punës sa më efikase; pajisjen e profesorëve, gjegjësisht zyreve të tyre me kompjuterë dhe mjete të tjera përcjellëse) dhe zhvillimin dhe funksionalizimin e bibliotekës së FSHJM (furnizimin e saj me tituj akademik, literaturë të kohës, etj.).
- Universiteti t'i ngritë kapacitetet jashtë kurrikulare.
- Krijimin e mundësive, transparencës dhe përfshirjen e stafit në vendimmarrje, si dhe aplikimin dhe përshtatjen e metodave më të mira sa i përket rekrutimit të personelit.
- Të organizojë kushte për mësimdhënie atraktive duke trajnuar stafin në metodat më të mira pedagogjike (funksionalizimin e zyrës për përsosshmërinë e stafit akademik).
- Intensifikimin e punëve në zyrën e projekteve.
- UUHP të krijojë kushte për sigurimin e transportit për studentë gjatë vizitave në teren dhe për vizitat studimore.
- Trajnime të stafit akademik për përdorimin e aparaturave.
- Trajnime që kanë për bazë metodat e mësimin me studentin në qëndër.
- Motivim më i madh i mësimdhënësve në lidhje me mundësitë për hulumtim ku përfshihen pajisjet për zyrë, literatura, pajisjet laboratorike, materialet shpenzuese laboratorike, aparaturat e nevojshme e pastaj edhe mbështetjet financiare pas botimeve.
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Nuk ka!
- Fakulteti Juridik: Komisioni rekomandon stafin akademik t'i përmbush në të ardhmen pyetësorët që iu jepën pasi që të gjitha janë të nevojshme për fakultetin.

## **17. Gjurmimi i studentëve (ALUMNI)**

### **17.1.Gjurmimi i studentëve (shtojca A.16.)**

Pyetëtori është i destinuar për studentët e diplomuar. Duke synuar sigurimin e cilësisë në procesin punësimit të studentëve të diplomuar, universiteti nëpërmjet të Qendrës së Karrierës dhe Alumnit siguron të dhëna lidhur me punësimin e studenëve në institucione publike dhe private, biznese dhe organizata të ndryshme e që përveç mekanizmave të tjerë bëhet edhe nëpërmjet pyetësorit të gjurmimit të studentëve. Pyetëtori është i hartuar në mënyrë që të siguroj informacione në lidhje me atë se sa janë të punësuar të diplomuarit, në cilin sektor (brenda apo jashtë profesionit), lidhja në mes të profilit të studimeve dhe tregut të punës, njohuritë dhe shkathtësitë e fituara dhe profili i punës. Pyetëtori përmban pyetje në lidhje me:

- në cilin sektor (brenda apo jashtë profesionit)
- lidhja në mes të profilit të studimeve dhe tregut të punës

- njohuritë dhe shkathtësitë e fituara dhe profili i punës.

Pyetësorit iu janë përgjigjur 329 të diplomuar/respondentë. 54 respondentë janë nga Fakulteti i Edukimit, 76 respondentë nga Fakulteti Ekonomik, 76 respondentë nga Fakulteti Filologjik, 15 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, 69 respondentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, 39 respondentë nga Fakulteti Juridik. Nga rezultatet e pyetësorit, të punësuar me kohë të plotë janë 125 të diplomuar, me kohë të pjesshme 33, të vetëpunësuar 22 dhe jo të punësuar 149 të diplomuar. Raporti paraqet statistika të përgjithshme, sygjerimet e studentëve.

## Raporti i të diplomuarve


1. Pjesëmarrja: 329

2. Diplomuar në ciklin e studimeve:

	<b>Bachelor</b>	<b>Master profesional</b>	<b>Master shkencor</b>
Nr	261	25	43
%	79,3%	7,6%	13,1%

3. Fakulteti ku keni diplomuar:

<b>Fakulteti</b>	<b>Ekonomik</b>	<b>Edukimit</b>	<b>Filologjisë</b>	<b>Juridik</b>	<b>Shkencave të jetës dhe mjedisit</b>	<b>Shkencave Kompjuterike</b>
Nr	76	54	76	39	15	69
%	23,1%	16,4%	23,1%	11,9%	4,6%	21%



4. Departamenti ku keni diplomuar:

Juridik	Fshk	Filologji	Ekonomi	Juridik	FSHJM	Edukim
30	79	75	105	40	10	43



5. Aktualisht, a jeni të punësuar?

	I/e punësuar me kohë të pjesshme	I/e punësuar me kohë të plotë	I/e vetëpunësuar	Jo i/e punësuar
Nr	33	125	22	149
%	10	38	6,7	45,3



6. A jeni i/e punësuar në drejtimin që keni përfunduar studimet?

	Po	Jo	Te tjera
Nr	180	123	26
%	54,7	37,4	7,9



7. Nëse jeni të punësuar, ju lutemi specifikoni vendin ku punoni.

- Raiffeisen Bank
- Asistent ne Fakultetin Ekonomik, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
- Shef per Buxhet dhe Financa
- München, Gjermani – Kontabilist Financiar
- Agjencia Pyjore e Kosovës
- Normann Engineering LLC

- Biznes personal dhe jam kontabiliste
- Banka Teb
- SHMP"ABDYL Ramaj" Shirokë-Suharekë
- Liridoni Distribution SH.P.K.
- Incodeks - Software Development Company
- Rems-Murr-Klinik Schorndorf-Germany
- Shfmu "Fadil Hisari" / UPZ (me orar të pjesshëm)
- Agjension të Statistikave të Kosovës
- Asistent në fakultetin juridik
- Hulumtues në një program të bashkimit evropian që quhet Lowcomote
- Jam praktikante në Gjykatë
- Qendra e Kompetencës Prizren
- Sales Assistant-Kujtesa
- Shkolla "Rifat Berisha"

8. Sa kohë pas diplomimit jeni punësuar?

Ka 228 përgjigje.

<b>Mbrenda 1 viti</b>	<b>Pas 1 viti</b>	<b>Pas 2 vite</b>	<b>Pas një periudhe më të gjatë</b>	<b>I/e punësuar para</b>	<b>I/e papunësuar</b>
79	34	24	29	29	33

9. Sa ju kanë ndihmuar studimet në punën që bëni?

Ka 241 përgjigje

<b>Aspak</b>	<b>Pak</b>	<b>Mesatar</b>	<b>Mjaftueshëm/Shumë</b>
11	27	48	155

10. Sa ju ka ndihmuar praktika profesionale që keni bërë gjatë studimeve, në vendin aktual të punës?

<b>Aspak</b>	<b>Pak</b>	<b>Mesatar</b>	<b>Mjaftueshëm/Shumë</b>
48	41	18	128

11. Cilat janë sugjerimet tuaja për programin e studimeve?

- Të implementohet dhe të verifikohet pjesa praktike më shumë!
- Të kenë më shumë praktikë sepse ju ndihmon shumë!
- Më shumë punë praktike sa i përket njohjes së punës profesionale dhe zbatueshmërisë së ligjeve dhe njohjes së procedurave ligjore!
- Të orientohen edhe studentët në të ardhmen në këto drejtime ngase ka filluar të ketë rritje të kërkesave për disa lëmi të caktuara të cilat i kemi në drejtimet gjegjëse në universitet!

- Renditja e lëndëve në bazë të viteve ka qenë pak e ngatërruar. Sugjeroj që lëndët në vitet e para të shqyrtohen dhe të ketë ndryshime!
- Sugjerim do të ishte që të vendoset lënda e statistikës në vitet e treta dhe të përfshihet programi SPSS sepse do të lehtësonte shumë studentët të qasen në botën shkencore dhe pse jo të publikojnë punime shkencore. Poashtu do të ndihmojë atyre edhe në temën e diplomës që do të kenë në fund të studimeve. Sugjerim tjetër do të ishte që studimet të orientohen më shumë nga praktika sepse vetëm pak kemi pas praktikë, pjesa dërmuese ka qenë teori.
- Programi i studimeve në të cilin i kam përfunduar studimet është shumë në nivel por ekziston pamundësia për kryerjen e praktikës profesionale dhe pastaj punësimit.
- Përfshirja e mjeteve të teknologjisë gjatë studimit në fakultet ku studentët bëjnë hulumtime kërkime për përgatitje profesionale, praktikë profesionale, materiale të përditësuara.
- Sugjerimet e mia janë që studentët sidomos të shkencave kompjuterike mos të mësojnë gjëra të kota si për shembull për ekonomi biznesi, gjithashtu disa lëndë në drejtimin software design janë të pakuptimta pasi që studenti duhet të dijë bazat e programimit e të vazhdojë me praktikë. Jo të mesoj databazë të thellë nga disa profesorë që as vetë nuk dijnë dhe ligjërojnë shabllon teori pa kurrfarë praktike. Mendimi im është që secili student ta gjej veten aty ku është më i mirë dhe jo të mësojë çka i jepet nga fakulteti!
- Të kemi profesorë më adekuat, të hapet urgjentisht programi për doktoraturë që të mund të kryhen më tepër hulumtime shkencore nga studentet tonë, të rritet rrjeti i kontakteve në këtë mënyrë, dhe kështu të bëhet krahasimi me universitetet tjera dhe përmirësimi i cilësisë nëse vërtetë jemi të interesuar të kontribuojmë në këtë drejtim.

### **Vlerësimi i mësimit online gjatë pandemisë COVID-19**

Pyetësi ishte i destinuar për studentët për të vlerësuar mësimin online të mbajtur gjatë pandemisë COVID-19. Pyetësi ka përmbytur 10 pyetje. Qëllimi i pyetësit ka qenë të identifikojë se sa studentë kanë qënë të kënaqur me:

- Mësimdhënien
- Mësimnxënien
- Platformën e përdorur
- Mësimin online si opsion.


Pyetësit iu janë përgjigjur 150 respondentë.

**Linku:**

[https://docs.google.com/forms/d/1xmMo3ho2OL7QgxhI6ixb1xvRQmJjsXY2Rp2IwC\\_i9co/viewform?chromeless=1&edit\\_requested=true&pli=1](https://docs.google.com/forms/d/1xmMo3ho2OL7QgxhI6ixb1xvRQmJjsXY2Rp2IwC_i9co/viewform?chromeless=1&edit_requested=true&pli=1)

6/10/2021

Vlerësimi i mësimit online




### Vlerësimi i mësimit online

150 responses

#### 1. Sa është efektiv mësimi online?

150 responses




[https://docs.google.com/forms/d/1xmMo3ho2OL7QgxhI6ixb1xvRQmJjsXY2Rp2IwC\\_i9co/viewanalytics](https://docs.google.com/forms/d/1xmMo3ho2OL7QgxhI6ixb1xvRQmJjsXY2Rp2IwC_i9co/viewanalytics)


1/6

### Sa është efektiv mësimi online?

6/10/2021



Vlerësimi i mësimit online





Në lidhje me pyetjen se sa ka qenë platforma e përshtatshme, 66% e respondentëve janë përgjigjur se platforma ka qenë e përshtatshme, kurse 34% janë përgjigjur se nuk ka qenë e përshtatshme.

Në lidhje me pyetjen nëse mësimdhënësit përdorin metodologji të përshtatshme mësimdhënie gjatë ligjërimit online, 70% janë deklaruar me “po”, kurse 30% janë deklaruar me “jo”.







Pyetjes se sa dëshirojnë studentët t'ju ofrohet mësimi online si opsion në të ardhmen 22.7% janë deklaruar që po, dhe 77.3% janë deklaruar jo.

Pyetjes kam vështirësi në të kuptuarit gjatë mësimit online 70% janë deklaruar që kanë vështirësi dhe 30% janë deklaruar që nuk kanë vështirësi gjatë mësimit online.

8/10/2021

Vlerësimi i mësimit online



[https://docs.google.com/forms/d/1xmMo3ho2OL7Qgxl6ixb1xvRQmJjsXY2Rp2lwC\\_j9co/viewanalytics](https://docs.google.com/forms/d/1xmMo3ho2OL7Qgxl6ixb1xvRQmJjsXY2Rp2lwC_j9co/viewanalytics)



4/6

Pyetjes kam vështirësi të kyçem në mësim për shkak rrjetit të dobët të internetit 73.3% janë deklaruar po dhe 26.7% janë deklaruar jo.

Pyetjes preferoj ta shoh profesorin në kamerë gjatë mësimit online 51.3% janë deklaruar po dhe 48.7% janë deklaruar jo.

6/10/2021

Vlerësimi i mësimit online



[https://docs.google.com/forms/d/1emMo3hc2OL7Ogrhffixb1wRQmJk/Y2Rz2Wc\\_9co/viewanalytics](https://docs.google.com/forms/d/1emMo3hc2OL7Ogrhffixb1wRQmJk/Y2Rz2Wc_9co/viewanalytics)

56

6/10/2021

Vlerësimi i mësimit online



This content is neither created nor endorsed by Google. [Report Abuse](#) - [Terms of Service](#) - [Privacy Policy](#)

Google Forms

Pyetjes mendoj që mësimi online është i papërshtatshëm 71.3% janë deklaruar që po dhe 28.7% janë deklaruar që jo.